



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**KPM-2017/06**

Bazuar në nenin 3, paragrafi 2.5 dhe 2.6 dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton:

## **RREGULLORE PËR TARIFËN VJETORE PËR LICENCË**

### **NENI 1 QËLLIMI**

1. Përcaktimi i nivelit të tarifës për aplikim për licencë të KPM-së për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.
2. Përcaktimi i nivelit dhe mënyrës së pagesës së tarifës vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.
3. Përcaktimi i nivelit të tarifës në lidhje me ndryshimin apo vazhdimin e licencës së KPM-së për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.

### **NENI 2 TARIFA PËR APLIKIM PËR LICENCË**

Parashtruesi i kërkesës me rastin e dorëzimit të aplikacionit për licencë për OSHMA dhe operator të shpërndarjes duhet ta paguajë një tarifë administrative në shumën e pakthyeshme prej njëqind Euro (100 €) në llogarinë bankare të KPM-së.

### **NENI 3 KATEGORIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO (radio) ME TRANSMETIM TOKËSOR ANALOG**

1. **Kategoria e radiove me mbulim nacional** - i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat mbulojnë me sinjal radio, përmes frekuencave, të paktën 95% të territorit të Republikës së Kosovës.
2. **Kategoria e radiove me mbulim regjional** – i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat mbulojnë me sinjal radio, përmes një frekuence, nga 30% deri në 60% të territorit të Republikës së Kosovës.

3. **Kategoria e radiove me mbulim lokal** – i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat ofrojnë mbulim me sinjal radio, përmes një frekuence, deri në tri komuna (deri në 30% të territorit të Republikës së Kosovës).
4. **Kategoria e radiove me fuqi të ulët transmetimi** - i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat përmes një frekuence, transmetojnë me më pak se 50 W fuqi efektive transmetuese.

#### **NENI 4**

### **KATEGORIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUALE (OSHMA) ME SHPËRNDARJE PËRMES TRANSMETIMIT TOKËSOR DIXHITAL**

1. **Kategoria e OSHMA me mbulim shtetëror** – përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit shtetëror.
2. **Kategoria e OSHMA me mbulim të zonës regjionale** – përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit regjional.
3. **Kategoria e OSHMA me mbulim të nën-zonës Prishtina** – përfshin Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat shpërndahen përmes operatorit të multipleksit të nën-zonës së kryeqytetit.

#### **NENI 5**

### **KATEGORIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUALE (OSHMA) ME SHPËRNDARJE PËRMES OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES**

Kategoria e OSHMA me shpërndarje përmes operatorëve të shpërndarjes përfshin të gjitha OSHMA-të që shpërndahen përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike jashtë brezit radio-difuziv.

#### **NENI 6**

### **KATEGORIZIMI I OPERATORËVE TË MULTIPLEKSIT**

1. **Multipleksi me mbulim shtetëror** – i përket operatorit të multipleksit të licencuar nga KPM, i cili përmes Planit të Frekuencave për Transmetim Tokësor Televiziv Dixhital në Republikën e Kosovës mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. **Multipleksi me mbulim regjional** – i përket operatorit të multipleksit të licencuar nga KPM, i cili përmes Planit të Frekuencave për Transmetim Tokësor Televiziv Dixhital në Republikën e Kosovës mbulon tërë territorin e zonës përkatëse.
3. **Multipleksi me mbulim të nën-zonës Prishtina** – i përket operatorit të multipleksit të licencuar nga KPM, i cili përmes Planit të Frekuencave për Transmetim Tokësor Televiziv Dixhital në Republikën e Kosovës mbulon tërë territorin e nënzonës përkatëse.

**NENI 7**  
**TARIFAT VJETORE PËR LICENCË PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE**  
**AUDIO (RADIO) ME TRANSMETIM TOKËSOR ANALOG**

Niveli i tarifës vjetore për ofruesit e shërbimeve mediale audio që operojnë nëpërmjet transmetimit tokësor analog përcaktohet si në vijim:

<b>Lloji i ofruesit të shërbimit medial audio</b>	<b>Tarifa vjetore (Euro)</b>
Radio me fuqi të ulët	140.00 (€)
Radio lokale	350.00 (€)
Radio regjionale	700.00 (€)
Radio nacionale	5,600.00 (€)

**NENI 8**  
**TARIFAT VJETORE PËR LICENCË PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE**  
**AUDIOVIZUALE (TV) ME TRANSMETIM TOKËSOR ANALOG**

Niveli i tarifës vjetore për ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale që operojnë nëpërmjet transmetimit tokësor analog përcaktohet si në vijim:

<b>Lloji i ofruesit të shërbimit medial audiovizual</b>	<b>Tarifa vjetore (Euro)</b>
TV me fuqi të ulët	210.00 (€)
TV lokale	560.00 (€)
TV regjionale	1,050.00 (€)
TV nacionale	7,000.00 (€)

**NENI 9**  
**KATEGORIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUALE**  
**(OSHMA) ME SHPËRNDARJE PËRMES TRANSMETIMIT TOKËSOR DIXHITAL**

Niveli i tarifës vjetore për ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me shpërndarje përmes operatorit të multipleksit përcaktohet si në vijim:

<b>Kategoria e OSHMA-së</b>	<b>Tarifa vjetore (Euro)</b>
OSHMA me transmetim në MUX shtetëror	2,500.00 (€)
OSHMA me transmetim në MUX regjional dhe nën-zonën Prishtina	500.00 (€)

**NENI 10**  
**TARIFAT VJETORE PËR LICENCË PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE QË OPEROJNË PËRMES OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES**

Niveli i tarifës vjetore për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale që operojnë nëpërmjet operatorit të shpërndarjes përcaktohet si në vijim:

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes	Tarifa vjetore (Euro)
TV	500.00 (€)
Radio	200.00 (€)

**NENI 11**  
**TARIFAT VJETORE PËR LICENCË PËR OPERATORËT E SHPËRNDARJES**

1. Shuma e tarifës vjetore për licencë për operatorët e shpërndarjes kabllorë dhe operatorët e shpërndarjes IPTV do të llogaritet sipas popullatës në zonat e shërbimit:

Operatorët e shpërndarjes (kabllorë, IPTV)	Tarifa vjetore (Euro)
Deri në 1.000 banorë	150.00 (€)
Prej 1.000 – 10.000 banorë	300.00 (€)
Prej 10.000 – 50.000 banorë	500.00 (€)
Prej 50.000 – 100.000 banorë	1,500.00 (€)
Prej 100.000 – 200.000 banorë	2,500.00 (€)
Prej 200.000 – 250.000 banorë	5,000.00 (€)
Mbi 250.000 banorë	20,000.00 (€)

1.1.I licencuari që operon në të njëjtën kohë si operator kabllor dhe IPTV, por në të dy platformat shpërndan të njëjtat kanale, obligohet të paguajë vetëm një tarifë vjetore për shërbimet e njëjta të ofruara në të dy platformat e licencuara.

1.2.I licencuari që operon në të njëjtën kohë si operator kabllor dhe IPTV, por shpërndan kanale të ndryshme në të dy platformat e licencuara, obligohet të paguajë tarifën vjetore veçmas për operator kabllor dhe veçmas për IPTV.

2. Shuma e tarifës vjetore për operatorët e shpërndarjes OTT përcaktohet si në vijim:

Operatorët e shpërndarjes	Tarifa vjetore (Euro)
OTT	5.000,00 (€)

3. Shuma e tarifës vjetore për operatorët e shpërndarjes përmes transmetimit satelitor përcaktohet si në vijim:

<b>Operatorët e shpërndarjes</b>	<b>Tarifa vjetore (Euro)</b>
Operatorë të shpërndarjes përmes transmetimit satelitor	1,500.00 (€)

#### **NENI 12**

#### **TARIFAT VJETORE PËR LICENCË PËR OPERATORË TË MULTIPLEKSIT**

1. Tarifa vjetore për operatorë të multipleksit në nivel shtetëror do të përcaktohet në materialin tenderues për licencimin e dy multipleksëve sipas Shtojcës së Ligjit për Dixhitalizim.
2. Tarifa vjetore për operatorë të multipleksit në nivel regional do të përcaktohet në pajtim në materialin e konkursit publik për licencim.

#### **NENI 13**

#### **MËNYRA E PAGESËS SË TARIFËS VJETORE**

1. Tarifa vjetore për licencë, për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së, do të depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur të Mediave deri më 30 qershor të vitit respektiv.
2. Në rastin e licencimit, tarifa e parë vjetore për licencë do të paguhet jo më vonë se 14 ditë nga pranimi i vendimit për licencim, ndërsa llogaritja e tarifës vjetore e licencës do të bëhet nga muaji në të cilin merret vendimi për licencim.
3. Në rast se të Licencuarit nuk e informojnë Komisionin e Pavarur të Mediave se nuk planifikojnë të vazhdojnë së ushtruar veprimtarinë e tyre më tutje, përgjegjësitë financiare që rrjedhin nga licenca do të jenë të vlefshme deri në momentin e dorëzimit të njoftimit me shkrim në KPM që i Licencuari heq dorë nga licenca.
4. Edhe nëse i Licencuari ndërprente aktivitetin para skadimit të kohës për të cilën kohë tarifa është paguar, pjesa e shumës së tarifës për kohën e mbetur nuk do të kthehet.

#### **NENI 14**

#### **TARIFA PËR NDRYSHIM DHE VAZHDIM TË LICENCËS**

Me rastin e dorëzimit të kërkesës për ndryshim të licencës ose vazhdim të licencës, parashtruesi i kërkesës duhet ta paguajë një tarifë administrative në shumën prej njëqind Euro (100.00 €) në llogarinë bankare të KPM-së. Pavarësisht vendimit të KPM-së, kjo tarifë administrative nuk i kthehet kandidatit.

**NENI 15  
SANKSIONET**


Në rast të mospagesës me kohë të tarifës për licencë, KPM do ndërmarrë masat në pajtim me Ligjin e KPM-së.

**NENI 16  
DISPOZITAT KALIMTARE**

1. Neni 8 i kësaj Rregulloreje do të jetë i aplikueshëm deri në shkyçjen e transmetimit televiziv analog tokësor.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja KPM-2017/03.

**NENI 17  
HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Adnan MEROVCI**  
Kryetar

22.12.2017  
Data